



Pranuar / Dostiguar Priljezura/Prodato Received/Delivered	24.04	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	In Prot In Prot Prot No	Shtojca Bilag Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM SHOK	3789/2023		115



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.377/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyll Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.377/2023 të datës 21.02.2023 të parashtruar nga ankuesi _____ me adresë rruga "Ahmet Krasniqi", në Komunën e Prishtinës, në çështjen juridike "vlerësim i rezultateve në punë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 24.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa A.nr.377/2023 e datës 21.02.2023 e parashtruar nga ankuesi _____
- II. Mbetet në fuqi Formulari për vlerësimin e rezultateve në punës për ankuesin për vitin 2022 i datës 30.01.2023.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ punësuar në Autoritetin e Aviacionit Civil sipas Akt Emërimit të datës 13.07.2012 në pozitën *Asistent i Logjistikës në kuadër të Departamentit për Burime Njerëzore*, me datën 21.02.2023, ka parashtruar ankesën me numër protokoli 1942/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Formularit për Vlerësimin e Rezultateve në Punë për vitin 2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 28.02.2023 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Autoriteti i Aviacionit Civil, ndërsa kjo e fundit me datën 09.03.2023 ka dërguar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Me datën 05.04.2023, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK/2023 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1942/2023 e datës 21.02.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2022 i datës 23.01.2023; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2022 i datës 25.01.2023; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2022 i datës 30.01.2023; E-mailat zyrtar të datës 04.11.2022, 26.10.2022, 25.10.2022, 13.10.2022, 14.12.2022, 05.12.2022, 23.11.2022, 20.09.2022; Shkresën zyrtare të datës 10.07.2020 lidhur me specifikacionin teknik lidhur me shërbimin për skanimin, regjistrimin, radhitjen dhe fajllimin e dokumenteve arkivore; E-mailat zyrtar të datës 04.11.2022, 27.10.2022, 26.10.2022, 11.10.2022, 06.10.2022, 18.01.2023, Shkresën zyrtare mbi dërgesë të datës 19.01.2023; E-mailat zyrtar të datës 19.10.2022; Shkresën zyrtare mbi dërgesë të datës 20.10.2022; E-mailat zyrtar të datës 27.01.2023, 26.01.2023; Shkresën zyrtare mbi dërgesë të datës 27.01.2023; E-mailat zyrtar të datës 21.12.2022, 13.12.2022; Shkresën zyrtare mbi dërgesë të datës 19.12.2022; E-mailat zyrtare të datës 02.12.2022, 01.12.2022, 30.11.2022, 22.11.2022, 21.11.2022, 15.11.2022, 14.11.2022, 11.11.2022, 10.11.2022, 07.11.2022, 03.11.2022, 02.11.2022, 28.10.2022, 27.10.2022, 25.10.2022, 24.10.2022, 21.10.2022, 19.10.2022, 18.10.2022, 17.10.2022, 13.10.2022, 12.10.2022, 11.10.2022, 07.10.2022, 06.10.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 28.02.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 09.03.2023 nga Autoriteti i Aviacionit Civil së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit; Akt emërimit të ankuesit të datës 13.07.2012; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2021 të datës 07.02.2022 të ankuesit; E-mailat zyrtar të datës 04.11.2022; Vendimin Nr.Ref:38/2021 të datës 10.12.2021, Vendimin Nr.Ref:42/2022 të datës 09.08.2022; Vendimin Nr.Ref:29/2022 të datës 29.09.2021; Vendimin Nr.Ref:31/2021 të datës 04.11.2021; Vendimin Nr.Ref:53/2022 të datës 04.10.2022; Vendimin Nr.Ref:58/2022 të datës 17.10.2022; Vendimin Nr.Ref:04/2023 të datës 08.02.2023; Vendimin Nr.Ref:47/2022 të datës 19.09.2022; Vendimin Nr.Ref:01/2023 të datës 17.01.2023; Vendimin Nr.Ref:01/2022 të datës 12.01.2022; E-mailat zyrtar të datës 16.01.2023, 21.12.2022, 16.12.2022, 15.12.2022, 11.10.2022, 14.07.2022, 12.07.2022, 04.07.2022; Memorandumin e datës 19.04.2022, 14.07.2022, 10.10.2022; E-mailat zyrtar të datës 29.11.2022, 21.11.2022, 31.10.2022, 24.10.2022, 10.10.2022, 04.10.2022, 26.09.2022, 19.09.2022, 12.09.2022, 06.09.2022, 02.08.2022, 25.07.2022, 19.06.2022, 12.07.2022, 05.07.2022, 27.06.2022, 31.05.2022, 23.05.2022, 26.04.2022, 19.04.2022, 12.04.2022, 28.03.2022, 21.03.2022, 14.03.2022, 07.03.2022, 28.02.2022, 21.02.2022, 14.02.2022, 18.01.2022, 28.12.2021, 12.12.2021, 30.11.2021, 22.11.2021, 16.11.2021; Raportin e punës së ankuesit të datës 18.11.2022, 25.11.2022, 18.11.2022, 28.10.2022, 21.10.2022, 14.10.2022, 07.10.2022, 30.09.2022, 23.09.2022, 16.09.2022, 09.09.2022, 02.09.2022, 11.08.2022, 05.08.2022, 29.07.2022, 22.07.2022, 15.07.2022, 08.07.2022, 01.07.2022, 24.06.2022, 20.05.2022, 13.05.2022, 22.04.2022, 15.04.2022, 08.04.2022, 01.04.2022, 24.03.2022, 18.03.2022, 11.03.2022, 04.03.2022, 25.02.2022, 16.02.2022, 11.02.2022, 21.01.2022, 14.01.2022, E-mailin zyrtar të datës 25.01.2023, 23.01.2023, 01.02.2023, 30.01.2023, 23.01.2023, 07.03.2023, 08.02.2023, 06.01.2023, 05.01.2023, 06.12.2022, 04.08.2022, 12.07.2022, 06.09.2022, 10.05.2022, 12.04.2022, 03.03.2022, 04.11.2022, 27.10.2022, 26.10.2022, 11.10.2022, 06.10.2022, 18.01.2023; Dërgesën e ankuesit të datës 10.01.2023; E-mailin zyrtar të datës

19.10.2022; Dërgesën e ankuesit të datës 20.10.2022; E-mailin zyrtar të datës 27.01.2023, 26.01.2023; Dërgesën e ankuesit të datës 27.01.2023; E-mailin zyrtar të datës 21.12.2022, 13.12.2022; Dërgesën e ankuesit të datës 19.12.2022; E-mailin zyrtar të datës 02.12.2022, 01.12.2022, 30.11.2022, 23.11.2022, 22.11.2022, 21.11.2022, 16.11.2022, 15.11.2022, 14.11.2022, 11.11.2022, 10.11.2022, 08.11.2022, 07.11.2022, 03.11.2022, 02.11.2022, 28.10.2022, 27.10.2022, 27.10.2022, 24.10.2022, 21.10.2022, 19.10.2022, 18.10.2022, 17.10.2022, 13.10.2022, 12.10.2022, 11.10.2022, 10.10.2022, 07.10.2022, 06.10.2022 dhe Vendimin VK/2023 me numër protokollit 3321/2023 të datës 05.04.2023 lidhur me vazhdimin e afatit të ankesës së ankuesit në Këshill.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale të çështjes në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, sepse:

Ankuesi në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Formularit për Vlerësimin e Rezultateve në Punë për vitin 2022 të datës 23.01.2023, pretendon që vlerësimi që i është bërë është më i dobëti prej se punon në AAC vetëm e vetëm pse mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ka shpreh mllëfin e vet dhe jo vlerësim të rezultateve në punë, sipas tij objektivat duhet të shtohen lidhur me punët shtesë tjera të cilat thekson se i kryen si menaxher i kontratave, i njëjti kërkon nga Këshillit që të kërkoj ti bëhet rivlerësim bazuar në dokumentet e dorëzuara.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit si dhe provave të lëndës, konstaton se bazuar në shkresat e lëndës të dërguara si nga organi i punësimit po ashtu edhe ankuesi, del se fillimisht të njëjtit me datën 23.01.2023 i është bërë vlerësimi sipas Formularit për Vlerësimin e Rezultateve të Punës të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesme, Ulët dhe Profesionale për vitin 2022 me notën e përgjithshme 3, ndërsa me datën 25.01.2023 bazuar në Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë ankuesi ka dhënë komentet tek ky formular lidhur me pakënaqësitë e tij komfor vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2022 e i cili gjithashtu mban notën e përgjithshme prej 3, si dhe me datën 30.01.2023 figuron Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022 për ankuesin në të cilin janë dhënë komentet nga ana e mbikëqyrëses së tij të drejtpërdrejtë dhe i cili edhe në bazë të këtij formulari del se është vlerësuar me notën e përgjithshme prej tre (3) që nënkupton vlerësimin "mirë". Kolegji i Këshillit ndërlidhur me vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin ka marrë për bazë Formularin për Vlerësimin e Rezultateve të Punës të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesme, Ulët dhe Profesionale për vitin 2022 të datës 30.01.2023 meqenëse i njëjti është përfundimtar pas dhënies së komenteve nga ana e ankuesit dhe mbikëqyrëses së tij të drejtpërdrejtë.

Referuar dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht nenit 43 paragrafit 1 dhe 2, është përcaktuar që: 1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues. 2. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e përcaktuar në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo institucionit",

ndërsa neni 5 paragrafin 1 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike përcakton se: *"Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin përbëhet prej fazave, si në vijim: 1.1. përcaktimin e objektivave; 1.2. vlerësimin e progresit të arritur gjatë periudhës së vlerësimit, për realizimin e objektivave të përcaktuara; dhe 1.3. vlerësimi në fund të periudhës vlerësuese (vlerësimi përfundimtar)"*, rrjedhimisht në bazë të provave të lëndës, vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesin është bërë në kuadër të objektivave të përcaktuara.

Duke u bazuar në provat e lëndës si dhe Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë te datës 30.01.2023 për vitin 2022, del se ankuesi nga mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë është vlerësuar me notën e përgjithshme prej 3, që nënkupton se i njëjti ka arritur të gjitha objektivat në kuptim të nenit 11 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcaktohet se: *1. Objektivat dhe sjelljet profesionale do të vlerësohen me nota nga 1 deri në 5. Rezultati përfundimtar i vlerësimit llogaritet në bazë të mesatares së marrë dhe paraqitur si në vijim: 1.3. nga 2.5 deri më pak se 3.5 nënkupton "mirë";* ndërsa në kuadër të kuptimit të notave sipas paragrafit 2 nën paragrafit 2.3 të këtij neni, përcaktohet që: *"mirë", vlerësohet nëpunësi, i cili ka realizuar të gjitha objektivat e punës, dhe ka treguar aftësi të pritshme të punës"*. Andaj bazuar në këtë, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesin është bërë në pajtim me nenin 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 4, 5 paragrafin 1 nën paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3, nenin 8, nenin 10, nenin 11 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3, paragrafin 2 nën paragrafin 2.3 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara, meqenëse i njëjti është vlerësuar me vlerësimin *"mirë"*, rrjedhimisht sipas Kolegjit të Këshillit ankuesit nuk i janë cenuar të drejtat për ngritje profesionale dhe ngritje në karrierë në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Ndërlidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili thekson faktin se përveç objektivave të përcaktuara në formular të vlerësimit duhet të jenë edhe shtimi i objektivave të tjera e me të cilat sipas vendimeve nga Drejtori i Përgjithshëm i këtij institucioni është i caktuar si menaxher i kontratave dhe kryen e përcjell punët lidhur me këtë fushë, Kolegji i Këshillit konstaton se në bazë të përshkrimit të detyrave të punës i njëjti është vlerësuar nga Udhëheqësja e tij e drejtpërdrejtë sipas fushave të cilat përkohë me përshkrimin e detyrave të punës, ndërsa për pjesën e menaxhimit të kontratave ankuesi nuk i përgjigjet direkt udhëheqëses së tij të drejtpërdrejtë lidhur me këtë fushë kështu që edhe mos vlerësimi për këtë pjesë të kryerjes së punëve shtesë të ankuesit nuk bie mbi përgjegjësinë e saj, andaj pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me këtë fushë është i pa bazuar dhe jo ligjor.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.377/2023, datë 24.04.2023.

Avdyl Bekteshi

Bekteshi
Zyrtar i lartë për bashkëpunim profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Malsore Gashi
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Aviacionit Civil dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.